AKADEMIA E DREJTËSISË
AKADEMIJA PRAVDE
ACADEMY OF JUSTICE

Buletini Informativ

* Hyrje
* Aktivitetet e përgjithshme
* Vlerësimi i nevojave Trajnuese
* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar
* Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)

Aktivitetet për sfatin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Tetor 2020

Hyrje

Ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor ka vazhduar edhe gjatë muajit tetor në pajtim me masat dhe kriteret e përcaktuara për mbrojtje dhe parandalim nga pandemia COVID 19. Të gjitha aktivitetet trajnuese janë realizuar përmes platformës Zoom dhe eleraning, për mësimin në distancë.

Aktivitetet trajnuese kanë qenë të fokusuara vetëm tek trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë si dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial meqë Programi Fillestar vazhdon përgatitjet për gjeneratën e re të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët priten fillimisht të dekretohen.

Përmes këtij buletini informativ në vijim pasqyrohen takimet nga bashkëpunimi ndërinstitucional, me donatorët dhe projektet me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta, aktivitetet në dobi të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të programit trajnues për vitin 2021 si dhe aktivitetet e realizuara nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme të specifikuara sipas temës së trajnimit, kohëzgjatjes dhe përfituesve të saj.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, buletini informativ përmban edhe njoftimin dhe zhvillimet sa i përket kurseve trajnuese të realizuara në platformën e mësimit në distancë gjatë muajit tetor.

Aktivitetet të përgjithshme

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e përbashkëta me donatorët dhe projektet

Gjatë muajit tetor është vazhduar mbështetja, bashkëpunimi dhe koordinimi me donatorët. Me qëllim të koordinimit të projekteve janë realizuar takime të përbashkëta me përfaqësues të KE-së dhe UNDP-së që vazhdojnë të mbështesin institucionet e drejtësisë në luftën kundër korrupsionit, pastaj janë realizuar takime me përfaqësues të projekteve tjera, punëtori, konferenca dhe aktivitetet tjera si në vijim:

AD në bashkëpunim me GIZ dhe Gjykatën e Apelit, në një ceremoni rasti kane publikuar Udhëzuesin për Procedurën e Konfliktit Administrativ të financuar dhe mbështetur nga projekti për reformë ligjore në Kosovë.

AD ka vazhduar bashkëpunim me projektin e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, për Forcimin e sistemit të Drejtësisë në Kosovë, me ç 'rast është realizuar punëtoria dy ditore për gjyqtaret dhe prokuroret pjesëmarrës në programin e monitorimit e mbështetur dhe financuar nga projekti. Përveç punëtorisë në takimin me . Jason Antley është arritur bashkëpunimi i mëtutjeshëm me fokus në zhvillimin dhe përditësimin e moduleve trajnuese në menaxhimin e rasteve dhe shkathtësive të buta.. Sipas kërkesës se z. Jason Antly , AD ka dërguar disa versione të moduleve trajnuese në fjale, si burim informacioni për ekipin e projektit

Në vazhdim gjatë këtij muaji AD ka pritur në takim Gjyqtaren Langarte nga Franca njëherësh zyrtare ndërlidhëse pranë Ambasadës Franceze në Beograd, dhe zyrtaren ndërlidhëse të Ambasadës Franceze në Prishtine, znj. Cecili. Gjatë takimit është diskutuar avancimi i bashkëpunimit ndërmjet AD dhe Shkollës së Magjistraturës për gjyqtare dhe prokurorë të Francës si dhe zgjatja e Marrëveshjes se Bashkëpunimit ndërmjet të dy institucioneve si dhe realizimi i programit të shkëmbimit.

AD po ashtu ka prite në takim përfaqësuesit e projektit të Unionin Evropian/ Programi për Sektorin e Drejtësisë në Kosove, ku është diskutuar fillimi i projektit dhe njëkohësisht mundësia e një këshilltari ndërkombëtar dhe një vendorë në asistence te vazhdueshme për 40 muajt e ardhshëm .

Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me Odën e Përmbaruesve të Kosovës, është diskutuar kërkesa e këtij institucioni për vlerësim të nevojave për trajnime. OPK në kërkesën për trajnime për vitin 2021 ka paraqitur gjithsejtë 13 tema të nevojshme për trajnime.

AD me kërkesë të përfaqësuesit të projektit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, në luftimin e angazhimit të fëmijëve në format e rënda të punës dhe punë të detyruara, kane realizuar një takim ku është diskutuar zhvillimi i një moduli trajnues për gjyqtaret dhe prokuroret e Republikës se Kosovës.

AD dhe OSBE gjatë këtij muaji kane realizuar një takim pune në lidhje me mbështetjen në hartimin dhe zhvillimin e modulit të trajnimit për gjyqtarët, prokuroret dhe zyrtarët policor në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë intervistimit. Po ashtu kanë realizuar ceremoninë e ndarjes së certifikatave të trajnimit për trajner për pjesëmarrësit në këtë program trajnimi.

AD me ftese të Programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022", si dhe projektit të tij "Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Evropën Jug-Lindore (JUFREX)"- Këshilli i Evropës, ka marr pjese në konferencën rajonale qe është organizuar si konferencë në të cilën kanë marr pjesë trajnerë të certifikuar nga JUFREX në mesin e tyre edhe trajnues gjyqësor nga Akademia e Drejtësisë.

AD me ftese të MPJ dhe Diasporës ka marr pjesë në takimin virtual Kosovë - Këshilli i Evropës, ku janë diskutuar të arriturat e projekteve të KE në mbështetje të institucioneve të Kosovës dhe nevoja për asistencë te mëtutjeshme.

AD në bashkëpunim me Projektin e USAID-it për Drejtësinë Komerciale, ka vazhduar diskutimin në lidhje me formimin komisionit të AD për vlerësimin e aplikuesve në programin e trajnimit për trajner TT. Në vijim, ka themeluar komisionin në përbërje prej 4 anëtareve nga AD dhe 1 anëtare ndërkombëtare e angazhuar nga projekti.

AD ka vazhduar me takimet e rregullta javore me z. Dragomir Yordanov, përfaqësuesin e projektit të BE / EUKOJUST të caktuar për ngritjen e kapaciteteve të AD-se. Në takime është diskutuar në lidhje me sfidat e AD-së dhe ndihmën e projektit, për planin e punës që është duke e hartuar projekti dhe nevojat dhe prioritet e AD në këtë plan, nisma e AD për zhvillimin dhe hartimin e programi trajnues kornize, qëllimet, objektivat dhe vizionin e programit trajnues. AD, sipas kërkesës së projektit ka ndarë një zyrë për nevojat e stafit të projektit..

Me ftese të projektit "Forumi i Shtatë Rajonal i Sundimit të Ligjit për Evropën Jug-Lindore", AD ka marr pjese në punëtorinë dy ditore e cila është realizuar në mënyre virtuale me pjesëmarrje nga të gjitha vendete e Ballkanit. Në punëtori, nga gjyqtaret e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshi edhe Kryetarin e saj, është diskutuar dhe debatuar në lidhje me praktikat dhe masat kufizuese të ndërmarra nga qeveritë në lidhje me luftën kundër pandemisë Covid 19. Nga gjyqtaret e GJEDNJ-së u prezantuan mendimet në lidhje me ligjshmërinë e masave në përputhje me KEDNJ.

AD dhe Organizata Joqeveritare INJECT Kosova, kane nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për realizimin e trajnimeve ne fushën e të drejtave pronësore të grave, trashëgimin, ndarjen e pronës së përbashkët. Projekti në kudër të asistencës në fjale pritet të angazhoje ekspert ndërkombëtar qe do të ofrojnë trajnime në AD .

AD ka zhvilluar takim me përfaqësues nga Projekti "Mbështetje e BE-së për Sistemin e Pronësisë Intelektuale në Kosovë", ku është diskutuar nevoja për trajnime ne këtë fushe si dhe përditësimi i modulit të trajnimit qe është ne platformën E- learning .

Bashkëpunimi i AD se dhe OPDAT ka vazhduar edhe më tej me ç 'rast është realizuar takimi i përbashkët në lidhje me koordinim e aktiviteteve trajnuese me projektet tjera. AD është informuar në lidhje me takimin koordinues që është mbajt ndërmjet OPDAT dhe projektit të BE-se EUKOJUST. Gjithashtu është shtruar nevoja për zhvillimin e një takimi koordinues ndërmjet AD-së , OPDAT dhe EKOJUST , e qe pritet të zhvillohet në vijim.

Takim me përfaqësues nga Programi i Sektorit të Drejtësisë të Bashkimit Evropian/Kosovës "EUKOJUST"

Më 08 tetor 2020, Drejtori Ekzekutiv, Enver Fejzullahu, ka pritur në takim z. Volkmar Theobald, Drejtuesi i ekipit të projektit, z. Cristian Nicoara, Ekspert afatgjatë për ndjekje penale dhe drejtësi penale dhe z. Dragomir Yordanov, ekspert afatgjatë për trajnim dhe ndërtim të kapaciteteve nga Programi i Sektorit të Drejtësisë të Bashkimit Evropian/Kosovës "EUKOJUST".

Drejtori Fejzullahu, fillimisht i ka falënderuar për mbështetjen e ofruar për Akademinë dhe i ka informuar për të arriturat dhe sfidat e deritanishme, proceset e rishikimit dhe nevojat për ndryshim, si dhe ka shprehur gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit në fushat e interesit të përbashkët ndërinstitucional, për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Përfaqësuesit e këtij projekti z. Theobald, z. Nicoara dhe z. Yordanov, njoftuan Drejtorin e AD-së rreth implementimit të Projektit nga i cili do të sigurojnë përfitim maksimal për të gjithë akterët në Kosovë, mënyrën e veprimit për tri vitet e ardhshme të zbatimit të projektit si dhe konfirmuan edhe njëherë, se do të kenë një bashkë koordinim në mbarëvajtjen e aktiviteteve duke synuar reformimin e mëtejshëm të sistemit të drejtësisë së Kosovës në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Konferenca Rajonale online për trajnerë të certifikuar nga JUFREX në mesin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve

Akademia e Drejtësisë me datën 08 tetor 2020 ka marr pjesë në Konferencën Rajonale online për trajnerë të certifikuar nga Projekti JUFREX - Kosovë që janë gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë – me temën boshte: Liria e shprehjes - zhvillimet më të fundit. Kjo konference është organizuar në nivel rajonal në të cilën kanë marr pjesë trajnerë të certifikuar nga JUFREX në mesin e tyre edhe trajnues gjyqësor nga Akademia e Drejtësisë. Kjo konferencë është organizuar përmes dhe në kuadër të Programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022", si dhe projektit të tij "Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Evropën Jug-Lindore (JUFREX)"- Këshilli i Evropës.

Kjo konferencë kishte për qëllim të avancoj nivelin e njohurive dhe shkathtësive të këtij grupi ekzistues të trajnerëve të certifikuar për Lirinë e Shprehjes. Gjatë kësaj konference u diskutuan mjetet aktuale të trajnimit që janë zhvilluar nga JUFREX, Manuali për Lirinë e Shprehjes për Trajnerët, kurset online të arsimit për të drejtat e njeriut për profesionistët e juridikut (HELP) për temën Liria e Shprehjes dhe Siguria e Gazetarëve, dhe e fundit, por jo nga rëndësia, zhvillimet e fundit në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për lirinë e shprehjes.

Me rastin e kësaj konference u trajtuan temat në vijim: Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Evropën Juglindore-JUFREX-2 - Fokusi, planet dhe rezultatet e pritura - mjetet e përditësuara dhe të reja të zhvilluara nën JUFREX-in, Kurset online HELP për sigurinë dhe mbrojtjen e gazetarëve, Zhvillimet më të fundit në jurisprudencën e GJEDNJ për lirinë e shprehjes. Të gjitha këto u shoqëruan me një rast studimor i cili u zbërthye gjerësisht nga të gjithë pjesëmarrësit e konferencës.

Në këtë konferencë që në fillim u potencua se liria e shprehjes, siç garantohet nga neni 10 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, është thelbësore për funksionimin e mirë të shoqërive demokratike. Kjo liri e shprehjes siguron, ndër të tjera, se debatet për çështje me interes publik mund të zhvillohen pa ndërhyrje të padrejta dhe që pjesëtarët e medias mund ta kryejnë punën e tyre në mjedis të sigurt dhe pluralist.

Në vazhdim u veçua mendimi se mbrojtja e lirisë së shprehjes varet kryesisht nga puna e profesionistëve ligjorë. Prandaj, është thelbësore që profesionistët ligjor të trajnohen mirë në standardet evropiane në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Për ta arritur këtë qëllim, Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Evropën Juglindore (JUFREX) mbështetet në trajnerët e JUFREX-it, një grup i gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia të trajnuar më parë për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, ashtu që të përgatiten për t'i trajnuar kolegët e tjerë në rajon për këtë temë.

Në debat u potencua se duke pasur parasysh pandeminë e paparë Covid-19, vazhdimi i certifikimit të trajnerëve bëhet edhe më i rëndësishëm. Përveç sfidave ekzistuese për lirinë e shprehjes, kriza Covid-19 i bën pjesëtarët e medias, veçanërisht të cenueshëm. Siç është parë në rrethana të ndryshme, nuk është e pazakontë që kriza të përdoret si pretekst për ta kufizuar lirinë e shprehjes dhe informimit ose pavarësinë e medias.

Në fund u konkludua se për Këshillin e Evropës mbetet përparësi vazhdimi i aktiviteteve të planifikuara të trajnimit dhe sigurimi i mjeteve për profesionistët ligjorë dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit që janë të nevojshme për ruajtjen e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias në nivelin kombëtar dhe rajonal. Për ta garantuar sigurinë e të gjithëve, kjo ngjarje u zhvillua në format të përzier duke kombinuar praninë fizike me trajnimin online. Kjo përfaqëson një mundësi unike për t'i ri-menduar këto ngjarje pa cenuar qëllimet ose cilësinë e tyre.

Në pjesën e fundit u trajtua një rast studimor tejet me dobi, në trajtimin e të cilit morën pjesë të gjithë pjesëmarrësit gjithanshëm përmes përfaqësuesve të delegacioneve nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse. Ky rast dhe debati pas tij u përmbyll me konkludimet e z. Dirk Voorhoof dhe z. Peter Noorlander, ekspert të Këshillit të Evropës dhe me fjalën përmbyllëse të znj. Martina Silvestri, Menaxhere e Programit të Këshillit të Evropës.

Ceremonia e certifikimit të prokurorëve për trajnimin Hartimi i Avansuar i Aktakuzave

Me 15 Tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me OSCE, ka bërë certifikimin e 14 prokurorëve të cilët kanë përfunduar me sukses Trajnimin për Trajnues me temë: "Hartimi i Avansuar i Aktakuzave" të zhvilluar nga dt. 31 Gusht 2020 deri më 04 Shtator 2020.

Gjatë ceremonisë Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu, falënderoj projektin e OSCE për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Akademisë, si dhe vlerësoj lartë kontributin e trajnuesve vendor dhe ndërkombëtar në zhvillimin e trajnimit.

U vlerësua se objektivat e trajnimit janë përmbushur duke bërë që prokurorët të cilët shërbejnë si trajnues në Akademi, kanë marrë njohuri shtesë rreth aktakuzave në përgjithësi, elementeve esenciale të aktakuzave, artin e të shkruarit, rolin dhe përgjegjësit e trajnuesit, parimet e të mësuarit etj.

E tërë ceremonia u zhvillua duke i respektuar masat e sigurisë të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike.

Memorandum Bashkëpunimi mes Akademisë së Drejtësisë dhe Initiative for Justice and Equality (INJECT)

Më 19 Tetor 2020, Akademia e Drejtësisë dhe Initiative for Justice and Equality (INJECT)

nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit në vazhdën e marrëveshjeve të bashkëpunimit të cilat është duke i realizuar Akademia edhe me Projektet tjera.

Qëllimi i Memorandumit ishte që të organizohen trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët në rritjen e kapaciteteve të tyre profesionale në fushën e të drejtave të grave dhe çasjen e tyre në drejtësi, e drejta e tyre për pronë, dhuna ndaj grave, dhuna ekonomike etj.

Me anë të këtij memorandumi palët u zotuan se do ta ndihmojnë njëra tjetrën në zhvillimin e trajnimeve si nga ana teknike ashtu edhe ajo profesionale, në shkëmbimin e informacioneve dhe praktikave më të mira në mënyrë që të përmbushen objektivat e trajnimit dhe efekti i tyre të jetë i drejtpërdrejtë tek gjyqtarët dhe prokurorët.

Vlerësimi i nevojave trajnuese

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga mekanizmat për vlerësim të nevojave trajnuese

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga burimet e ndryshme për vlerësim të nevojave trajnuese ka vazhduar edhe gjatë muajit tetor. Akademia e Drejtësisë edhe më tej ka bërë përpjekje për të shteruar gjitha mundësitë dhe përfshirjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë proces.

Përveç takimeve të drejtpërdrejta me gjyqtarë dhe prokurorë, Akademia e Drejtësisë edhe përmes shkresave nga përfituesit e saj ka pranuar propozime shtesë të cilat janë integruar në draftin e skemës programore.

Në shkresat e pranuara përveç propozimeve me temat përkatëse në fushën civile dhe administrative të cilat janë pranuar gjatë këtij muaji është vërejte edhe nevoja edhe sa i përket metodologjisë së zbatimit të programit. Sipas propozimeve Akademia e Drejtësisë duhet të orientojë programin trajnues përmes tryezave të fokusuara në raste praktike në mënyrë që pjesëmarrësit të njohin problematikat por edhe mënyrën e evitimit të metave në praktikën gjyqësore. Gjithashtu kërkohet që në fund të çdo tryeze moderatorët e tryezës të ofrojnë një raport të shkruar lidhur me diskutimet që kanë ndodhur në tryezë dhe me konkluzionet e nxjerra nga tryeza. Këto konkluzione do t'i shërbejnë edhe praktikës gjyqësore por edhe Akademisë për ti adresuar ato përmes programit trajnues apo edhe përmes publikimeve të ndryshme.

Përveç trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë në propozimet për trajnim është konfirmuar edhe nevoja për trajnime edhe për bashkëpunëtorët profesional si dhe zyrtarët ligjor. Më tutje në propozime është rekomanduar nevoja e trajnimeve bazë për këto kategori, analog me trajnimin fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar

Këto dhe propozime tjera Akademia e Drejtësisë i ka marrë në konsideratë duke i mbledhë dhe klasifikuar sipas fushave për ti adresuar më tutje me ekspertët për hartimin e programit trajnues dhe deri në finalizim me Këshillin Programor dhe Këshillin Drejtues të AD-së.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Hartimi i moduleve trajnuese

Edhe gjatë muajit tetor është vazhduar me përgatitjet për trajnimin fillestar për gjyqtarët që priten të dekretohen së shpejti meqë 22 kandidatë potencial për gjyqtarë i kanë kaluar gjitha fazat e rekrutimit në KGJK.

Prandaj, Akademia e Drejtësisë është në proces të hartimit të moduleve trajnuese sipas përmbajtjes së përcaktuar nga ky program, si dhe materialet tjera përcjellëse.

Në periudhën raportuese janë finalizuar modulet si në vijim: Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinore si dhe Legjislacioni dhe Shkathtësitë plotësuese. Modulet e tjera janë në proces e sipër.

Po ashtu është vazhduar me procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të programit trajnues për prokurorët e rinj për të cilët ka filluar procesi i rekrutimit nga KPK.

Bazuar në metodologjinë për vlerësim të nevojave trajnuese ky proces është në fazën e përpunimit të propozimeve të dala nga mekanizmat vlerësues.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: "Lejimi i përmbarimit dhe procedura sipas prapësimit, ankesës dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike në procedurën përmbarimore"

Më 1 Tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë: "Lejimi i përmbarimit dhe procedura sipas prapësimit, ankesës dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike në Procedurën Përmbarimore".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zgjërimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me titujt përmbarimor dhe procedurën sipas prapësimit, ankesës dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike në funksion të zbatimit të rregullte dhe të ligjshëm të procedurës përmbarimore në çdo rast konkret.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan titujt përmbarimor dhe lejimi i përmbarimit të tyre duke vënë në pah që përmbarimi të jetë lejuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për procedurë përmbarimore meqë nga kjo varet fillimi, zhvillimi dhe përfundimi i ligjshëm i procedurës përmbarimore. Në vijim janë elaboruar edhe prapësimi, ankesa dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në procedurën përmbarimore. Të gjitha këto mjete sqaruan përmes shembujve praktikë duke i adresuar çështjet më sfiduese të cilat hasen në praktikën e gjykatave.

Metodologjia e zbatuar gjatë trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit të Kosovës dhe niveli themelor nga të gjitha regjionit si dhe prokuror nga niveli themelor, Avokatë Shtetëror dhe staf administrativ nga gjykata dhe prokuroria.



Trajnimi: Zbatimi i udhëzuesit për politikat ndëshkimore

Më 6 dhe 7 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin virtual përmes platformës ZOOM me temë "Zbatimi i udhëzuesit për politikat ndëshkimore".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë në zbatimin në praktikë të udhëzuesit i cili synon unifikimin e politikës ndëshkimore në të gjitha gjykatat.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtua Udhëzuesi për politikat ndëshkimore i cili ka për qëllim që kryerësit e veprave penale të natyrës së njëjtë dhe rrethanave përafërsisht të njëjta tu shqiptohen dënime të përafërta dhe mos të ketë jo konsistencë në dënime prej një gjykate në tjetrën.
Gjatë diskutimeve u ngritën shqetësime për rastet e shqiptimit të dënimeve pa u bërë vlerësim adekuat i rrethanave dhe po ashtu pa arsyetim të mjaftueshëm të këtyre rrethanave. Prandaj, vëmendje gjatë trajnimit iu kushtua, rrethanave lehtësuese dhe rënduese karakteristikë e te cilave është se nuk janë shteruese pra, mund të merren edhe rrethana tjera. Gjatë trajtimit të këtyre çështjeve u vu në pah se rrethanat rënduese janë të prira për të qenë më specifike dhe të qarta sesa rrethanat lehtësuese, kurse është në pajtim me konceptin e pranuar se rrethanat të cilat e ashpërsojnë dënimin duhet të jenë të sakta, të qarta dhe të mund të provohen.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional të nivelit themelor të regjioneve të ndryshme të Kosovës.



Trajnimi: Mbrojta e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje

Më 07-08 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: "Mbrojta e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje" në kuadër të PTV-së. Në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që t'iu mundësoj njohjen me aspektet ligjore, qoftë vendore apo ndërkombëtare, si dhe praktikën gjyqësore të ofrimit të ndihmës dhe mbrojtjes së fëmijëve përgjatë zhvillimit të procedurave përkatëse gjyqësore, në rastet kur ka të bëjë me konteste martesore.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan temat si: Parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, kriteret që merr për bazë gjykata në rastet e besimit të fëmijëve dhe parimet për përcaktimin e alimentacionit; Dhuna në familje, urdhri për mbrojtje dhe procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje; llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre, ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrit për mbrojtje.

Në trajnim u theksua se martesa është bazë e familjes, e familja është bazë e shoqërisë, ku në martesë realizohen edhe interesat e shoqërisë, prandaj shoqëria ka për detyrë që me instrumente juridike dhe me instrumente të tjera, të krijoj kushte të nevojshme për martesë të harmonishme.

Në vazhdim u theksua se nga hulumtimi dhe studimi i ndikimit të shkurorëzimit tek fëmijët rezulton se gjatë procedurës së shkurorëzimit shpesh herë fëmijët ndikohen dhe manipulohen nga prindërit. Rrethanën e ndikimit dhe manipulimit të fëmijëve nga prindërit e konfirmojnë punëtoret e Qendrave për Punë Sociale siç janë: sociologët, pedagogët, psikologët, mësuesit por edhe gjyqtarët të cilët trajtojnë rastet e kontesteve martesore-familjare.

Gjithashtu u potencua se me dispozitën e nenit 138 të LFK-së, është paraparë ushtrimi i kujdesit nga Organi i Kujdestarisë. Sipas kësaj dispozite parashihet se Organi i Kujdestarisë vendos në emër të interesave të fëmijës vetëm më kërkesën e njërit ose të dy prindërve, me kërkesën e personit të tretë, në rastet kur kujdesi i fëmijës është nën mbikëqyrjen e tij ose me vendimin e gjykatës. Ligji për Familjen në nenin 6 përcakton Organi i Kujdestarisë ka në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror (kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial dhe adoptimi).

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjyqtar dhe prokuror të nivelit Themelor nga gjitha regjionet e Kosovës, bashkëpunëtorë profesional si dhe zyrtarë për mbrojtjen e viktimave.

Trajnimi: Analizë e rasteve praktike dhe shkathtësitë e avokimit në gjykim

Me 07 dhe 9 tetor 2020, në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar, në kuadër të projektit " Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë, i implementuar nga Axiom International Ltd është realizuar trajnimi me temë "Analizë e rasteve praktike dhe shkathtësitë e avokimit në gjykim".

Qëllimi këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve përmes diskutimeve, prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të rasteve nga praktika në demonstrimin e fjalës hyrëse, shtrimit te pyetjeve të drejtpërdrejta, dhe fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit.

Trajnimi u realizua në formë të kombinuar me ç 'rast disa nga pjesëmarrësit ishin të pranishëm fizikisht në sallë ndërkaq një pjesë e tyre përmes platformës ZOOM .

Gjatë trajnimit u analizua çështja e zbatimit të shkathtësive të avokimit në lidhje me paraqitjen prokurorit të shtetit në gjykimet penale. Vëmendje të veçantë kishte analizimi i fakteve-provave nga ana e prokurorit të shtetit të cilat duhet ti ketë parasysh që nga fillimi i hetimit gjer në ngritjen aktit akuzues sepse nga kjo, do të varet edhe suksesi i tij në gjykim. Gjithashtu i një rëndësie të veçantë kishte edhe fjala hyrëse, shtrimi i pyetjeve të drejtpërdrejta, atyre të tërthorta si dhe fjala. përfundimtare. Lidhur me këto u potencua që kanë rëndësi shumë të madhe për një përfaqësim të denjë të prokurorit në gjykatë dhe gjithashtu edhe në suksesin e gjykimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga rajone të ndryshme të Kosovës.

Trajnimi: E drejta në pronë-Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut

Më 13 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuan trajnimin, me temë "E drejta në pronë-Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut ".
Ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e

Njeriut (GjEDNj) mbi këtë nen, duke u thelluar në konceptet kryesore të dala nga kjo praktikë.
Në ditën e trajnimit u trajtuan temat si: E drejta në Pronë – Struktura e Nenit 1 – Protokollit 1 të KEDNJ-së; Interpretimi "autonom"; Hapat e vlerësimit të gjykatës dhe Pranueshmëria e kërkesës; Pasuria dhe ndërhyrja në gëzimin paqësor të pasurisë; Pritja Legjitime, Proporcionaliteti: arritja e baraspeshës së drejtë; Shpronësimi, kompensimi dhe rikthimi (restituimi) i pasurisë.

Në trajnim u theksua se e drejta në pronë është e drejtë e garantuar me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në thelb, ky nen ua garanton personave të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre. Pra, nga përmbajta e tekstit, por sidomos nga praktika gjyqësore, ky nen nuk e garanton të drejtën për të fituar pasurinë të drejtën për të blerë apo për të marrë pasuri por vetëm e mbronë atë që tashmë është fituar.

Në vazhdim u theksua se përveç ligjshmërisë, njëra nga çështjet kryesore që diskutohet është parimi i proporcionalitetit i cili në shumicën dërmuese të rasteve shtetet arsyetohen para Gjykatës se ndërhyrjet të cilat ato i kanë bërë në këtë të drejtë kanë qenë ndërhyrje me qëllim të interesit të përgjithshëm, duke favorizuar kështu të mirën e shumicës mbi të mirën e një individi. Përmes praktikës së saj, gjykata vazhdimisht ka bërë thirrje që të ketë një marrëdhënie të arsyeshme midis masave të ndërmarra dhe qëllimeve që ndiqen. Pra, çfarëdo mase e ndërmarrë nga shteti, me të cilën kufizohet gëzimi paqësor i pasurisë, në një shoqëri demokratike duhet të jetë e drejtuar kah arritja e një qëllimi legjitim.

Gjithashtu u potencua se Gjykata ka theksuar disa herë se marrja e pasurisë pa pagesën e një shume të arsyeshme afër vlerës së pronës, normalisht përbën një ndërhyrje jo proporcionale dhe një mungesë e plotë e kompensimit justifikohet me Nenin 1 të Protokollit 1 vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Më tej u tha që shteti duhet të kujdeset që çfarëdo forme e kompensimit që caktohet nga shteti, të jetë efektive- që të mund të realizohet. Arsyetimi se shteti mund të mos ketë mjete të mjaftueshme që të mos t'i realizojë kompensimet, nuk merret parasysh nga Gjykata.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjyqtar nga Gjykata Themelore si dhe bashkëpunëtorë profesional.

Trajnimi: Procedura kundërvajtëse sipas kërkesave të inspektorateve

Më 15 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve në PTV, ka realizuar trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë me temë "Procedura kundërvajtëse sipas kërkesave të inspektorateve".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve në implementimin e drejtë të metodave bashkëkohore të vlerësimit te kërkesave të bëra nga institucionet me theks të veçantë të inspektorateve.

Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom u trajtuan kushtet rreth formave të Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse në rastet kur Inspektoratet kanë ushtruar kërkesë si dhe vendimet të cilat mund nxirren në procedurën kundërvajtëse nga ana e gjykatës. Vëmendje parësore iu kushtua ngritjes së shkathtësive në vlerësimin e përmbajtjes dhe të formës së kërkesave të cilat shpesh në praktikë duhet të kthehen në plotësim, në mënyrë që të mos të paraqiten më vonë vështirësi në vështrim të nenit 56 të Ligjit për Kundërvajtje. Në vijim u trajtuan edhe zbatimi konsekuent i dispozitave ligjore që duhet të aplikuar për rastet e vendosjen një çështje kundërvajtëse nga ana e gjykatës.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtar nga te gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnimi: Mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme sipas ligjit për procedurën kontestimore

Më 20 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: "Mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme sipas ligjit për procedurën kontestimore" në kuadër të PTV-së. Në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom.

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me procedurën e paraqitjes së mjeteve juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nga ana e palëve të autorizuara, si dhe vendosjen e gjykatave të instancave më të larta rreth këtyre mjeteve.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan temat si: Procedura e vendosjes me ankesë; Procedura e vendosjes sipas revizionit; Procedura e vendosjes sipas propozimit për përsëritje të procedurës; Raporti në mes revizionit dhe propozimit për përsëritje të procedurës si dhe Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

Në trajnim u theksua se vet ekzistimi i gjykatave në instanca të ndryshme është garanci për palën që gabimet eventuale me apo pa qëllim të gjykatave më të ulta të kenë mundësi të evitohen dhe korrigjohen nga gjykatat e instancave më të larta. Pala e pakënaqur e cila mendon se vendimi i gjykatës së shkallës më të ultë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, ka mundësi që ta aktivizojë sistemin e kontrollit të vendimeve, duke përdorur fillimisht mjetet e rregullta juridike dhe më pastaj edhe përmes mjeteve të jashtëzakonshme, duke kërkuar vendosjen e drejtësisë.

Në vazhdim u potencua se e drejta e goditjes së vendimeve është një e drejtë elementare e cila garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës por edhe me Ligjin për Procedurën Kontestimore. E drejta në ankesë ndaj një vendimi gjyqësor është edhe standard i së drejtës ndërkombëtare të drejtave të njeriut, e jo thjeshtë vetëm një e drejtë që buron nga legjislacioni i brendshëm i një shteti.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtar nga Gjykata e Apelit, gjyqtar nga Gjykata Themelore si dhe bashkëpunëtor profesional.



Trajnimi: Etika Profesionale Prokurorët - Gr. III

Më 21 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuan trajnimin, me temë "Etika Profesionale ".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të rasteve nga praktika të ngritën vlerat e respektimit te normave etike dhe të mirësjelljes.

Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom u trajtuan etika dhe normat tjera të mirësjelljes, rëndësisë së profesionalizmit, integritetit dhe dinjitetit moral, parimit të pavarësisë dhe paanësisë si dhe faktorëve që ndikojnë në cenimin e këtyre normave. Siç është potencuar përmes trajnimit këto norma kanë ndikim në ngritjen e standardeve më të larta të sjelljes etike dhe kanë ndikim në forcimin e besimit të publikut ndaj sistemit në tersi. Më tej u tha që prokuroret duhet të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, të shmangen çdo konflikt interesash të shmangin gjithnjë komunikimin ex parte me palë. Këta duhet të veprojnë në atë mënyrë që të kontribuojnë dhe të ngritin besimin te publiku për sistemin prokuroral. Vazhdimisht të kërkojnë respektimin e rreptë të rendit dhe sjelljes së përshtatshme gjatë ushtrimit të funksionit të tyre dhe të ruajnë dhe të përpiqen vazhdimisht të përmirësojnë standardet më të larta profesionale dhe të ekspertizës ligjore.

Vëmendje gjatë trajnimit iu kushtua edhe procedurës disiplinore ndaj prokurorëve ku përfshihen ndryshimet ligjore me theks të veçantë veprimet e prokurorit që përfshihen në shkelje disiplinore, masat disiplinore, ankesat dhe përmbajtja e saj si dhe veprimet e Autoritetit kompetent.

Përfitues të këtij trajnimi ishin kryeprokuroret e prokurorive themelore si dhe prokurorë nga regjionet e ndryshme të Kosovës.



Trajnimi: Fitimi i pronësisë në mënyrë orgjinere/ Komentimi i rasteve-vendimeve të gjykatave

Më 21 Tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e BE-së - "Mbështetje Kodit Civil Faza 2", në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme organizoj trajnimin me temë: "Fitimi i pronësisë në mënyrë orgjinere/ Komentimi i rasteve-vendimeve të gjykatave". Ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom direkt/live nga ora 10:00-15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me risitë dhe ndryshimet që do të sjellë Kodit i ri Civil për dispozitat ligjore në fuqi me fokus në mënyrën e fitimit origjiner të pronësisë, duke u përqendruar në praktiken e gjykatave.

Me rastin e këtij trajnimi u elaborua koncepti i pronësisë sipas ligjit në fuqi dhe mënyrat e fitimit të pronësisë në mënyrë origjinere përmes shembujve dhe rasteve nga praktika e gjykatave e më pastaj edhe risitë në rregullimin e titujve juridikë për fitimin e pronësisë dhe fitimit origjinerë. Në vazhdim është trajtuar edhe mënyra e interpretimit të zbatimit të dispozitave ligjore lidhur me fitimin dhe humbjen e pronësisë si dhe unifikimi i vendimeve të gjykatave në zgjidhjen e këtyre rasteve.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, paraqitja e këndvështrimeve të pjesëmarrësve, prezantimi përmes PowerPoint, pyetje-përgjigjet dhe analizimi i rasteve nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, gjyqtarët nga gjykata Themelor nga te gjitha regjionet e Kosovës dhe staf administrativ nga gjyqësori dhe prokuroria.



Trajnimi: Procedura Administrative dhe Procedura e Konfliktit Administrativ në fushën e Skemave Pensionale, Kontestet e Shërbimit Civil, Tatimi dhe Dogana dhe Agjencisë Kadastrale

Më 22 tetor 2020, në bashkëpunim me GIZ – Projekti për Reformat Ligjore dhe Administrative LARP është realizuar trajnimi me temë: "Procedura Administrative dhe Procedura e Konfliktit Administrativ në fushën e Skemave Pensionale, Kontestet e Shërbimit Civil, Tatimi dhe Dogana dhe Agjencise Kadastrale". Ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në zbatimin e drejtë të ligjit të procedurës administrative në përgjithësi në kontestet e tatimit dhe doganave, shërbimit civil, skemave pensionale dhe kadastrit.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan temat si: Procedura Administrative në Kontestet e Tatimit dhe Dogana; Procedura Administrative në fushën e Skemave Pensionale, Shërbimit Civil dhe Agjencitë Kadastrale; Procedura në Konfliktin Administrativ në Kontestet e Tatimit dhe Dogana; Procedura në Konfliktin Administrativ në fushën e Skemave Pensionale, Shërbimit Civil dhe Agjencitë Kadastrale.

Në trajnim u theksua se procedura administrative fillon sipas kërkesës të palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik në çështjet në të cilat, sipas ligjit apo natyrës së çështjes, kërkohet kërkesa e palës, ku organi publik mund të veprojë vetëm në bazë të një kërkese të tillë. Fillimi i një procedure administrative sipas detyrës zyrtare është në diskrecionin e ligjshëm të organit publik, përpos në rastet kur ligji parasheh shprehimisht detyrimin për të filluar një procedurë, organi publik vihet në dijeni të fakteve që kërkojnë fillimin e procedurës në mënyrë që të mbrohet interesi publik.

Në vazhdim u potencua se ankesat për vlerësimet tatimore apo përcaktimet zyrtare të bëra nga ATK ekskluzivisht drejtohen nga dispozitat e ankesave të parapara në Nenin 77 të Ligjit për Administratën Tatimore, ku personi i cili nuk pajtohet me vlerësimin tatimor, përcaktimin zyrtar apo dokumentet tjera tatimore të lëshuar nga ATK apo kërkesat se të drejtat dhe obligimet e tij nuk janë respektuar për shkak të mos-veprimit të ATK-së mund të ankohet në Departamentin e Ankesave.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtar nga Gjykata e Apelit, gjyqtar nga Gjykata Themelore nga gjitha regjionet e Kosovës, bashkëpunëtorë profesional si dhe zyrtar për mbrojtjen e viktimave.

Program i Specializuar Trajnimi- Krimi i organizuar dhe korrupsioni-Sesioni III

Më 27-28 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme organizoj trajnimin përmes platformës Zoom me temë "Program i Specializuar Trajnimi - Krimi i organizuar dhe korrupsioni-Sesioni III".

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë lidhur me natyrën dhe format e korrupsionit si dhe veprat penale që janë të ndërlidhura me korrupsionin.

Gjate këtij trajnimi u prezantuan temat: Sekuestrimi i pasurisë së fituar më vepër penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit, konfiskimi i pasurisë së fituar më vepër penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit në procedurë të rregull dhe sipas Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, Sanksionet penale ndaj kryerësve të veprës penale të krimit të organizuar dhe korrupsioni.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, paraqitja e këndvështrimeve të pjesëmarrësve, prezantimi përmes PowerPoint, pyetje-përgjigjet dhe analizimi i rasteve nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarët nga Departamenti Special, gjyqtarët dhe prokuror nga gjykata dhe prokuroritë Themelore nga te gjitha regjionet e Kosovës dhe staf administrativ nga gjyqësori dhe prokuroria.



Trajnimi: "Regjimi pasuror martesor sipas Kodit Civil / Komentim i rasteve të gjykatave"

Më 28 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e Projektit për Kodin Civil të Bashkimit Evropian organizoj trajnimin me temë: "Regjimi pasuror martesor sipas Kodit Civil / Komentim i rasteve të gjykatave". Ky trajnim u mbajt virtualisht – përmes platformës zoom.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me risitë që do të sjell Kodi Civil i Republikës së Kosovës për regjimin pasuror.

Në pjesën e parë të trajnimit fokusi ishte në: Risitë e Kodit Civil, sfidat në implementimin e dispozitave të reja të KC, Koncepti i regjimit pasuror martesorë, Pasuria e veçantë dhe pasuria e përbashkët sipas ligjit të fuqi, Diskutim i vendimeve të gjykatave, dhe Sfidat në zbatimin e legjislacionit lidhur me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Risit në Kodin Civil lidhur me regjimin pasuror martesor, Pasuria e përbashkët dhe pasuria e veçantë dhe Kontrata paramartesore si dhe ajo martesore.

Që në fillim u prezantuan zhvillimet e fundit në Projekt-Kodin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin do të bëhen zhvillime të rëndësishme në të drejtat pronësore. Më tej në trajnim u veçuan risitë që sjell Kodi Civil lidhur me regjimin pasuror martesor si: Pasurinë e përbashkët, Pasuria e veçantë dhe Kontratën paramartesore/martesore, Neni 1170-1173. U veçua mendimi se rregullat e regjistrimit mbeten të njëjta në Kodin Civil. Koncepti i bashkëjetesës është sqaruar më mirë në Kodin Civil, po ashtu Rregullat e pjesëtimit mbeten të njëjta sa i përket procedurës dhe organit kompetentë.

Aktualisht në Kosovë në fuqi është Ligji i Familjes i Kosovës (LFK) dhe ky është ligj special i cili edhe i rregullon marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në martesë që nga fillimi e deri në përfundimin apo zgjidhjen e martesës. Me ndryshimet e LFK në vitin 2018, pjesët e pasurisë dhe kontributet janë të barabarta, përveç nëse janë marrë vesh ndryshe. Edhe në Kodin Civil, kontributet janë të barabarta, përveç nëse ka marrëveshje paramartesore ose martesore.

Pas diskutimeve u potencua se për deri sa legjislacioni në fuqi krijon mundësi që ndarja e pasurisë së përbashkët në mes të bashkëshortëve të bëhet në mënyrë jo të barabartë, Kodi Civil e ka mënjanuar këtë mundësi. Sipas Kodit, në rast të divorcit, pasuria e përbashkët e bashkëshortëve ndahet në pjesë të barabarta (1/2). Përjashtim nga kjo, bën vetëm kontrata para martesore ose gjatë martesës, ku mund të parashihet një ndarje tjetër e pasurisë. Kriteri ligjor për ndarjen në pjesë të barabarta në Kod, është bërë për arsye të mbrojtjes së të drejtave të grave në Kosovë, që në raste të caktuara janë diskriminuar në këtë drejtim.

Duke rezimuar u konkludua se Kodi Civil ka paraparë rregulla tjera të regjimit pasuror të bashkëshortëve. LFK, vazhdon të zbatohet deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil por gjykatat duhet të përgatiten për zhvillimin në mënyrë të re të zbatimit të ligjit, duke u përshtatur ndryshimeve të reja në Kodin Civil.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, interpretime të thelluara të ligjit, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore dhe shoqëruar me diskutime interaktive, analizës së disa rasteve nga praktika gjyqësore dhe dispozitave ligjore që përmban Projekt-Kodi Civil i Kosovës.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e fushës civile nga të gjitha nivelet e Republikës së Kosovës.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Tranjnimi: Shkrimi dhe arsyetimi ligjor

Më 14 Tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial ka realizuar trajnimin me temë "Shkrimi dhe arsyetimi ligjor"

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja analitike dhe e shkathtësive për të shkruar në mënyrë efektive me rastin e hartimit të akteve dhe vendimeve gjyqësore duke zbatuar drejtë parimet e shkrimit më të mirë ligjor, metodat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor si dhe kërkesat ligjore për përmbajtjen e arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

Gjatë këtij trajnimi u diskutua për procesin dhe parimet e të shkruarit mirë ligjor si dhe shkrimi dhe arsyetimi ligjor përmes metodës IRAC. Vëmendje të veçantë kishte rëndësia dhe nevoja për procesin analitik duke u fokusuar në udhëzimet për shkrim dhe arsyetim të aktgjykimeve si dhe në teknikat e hulumtimit ligjor.

Me rastin e këtij trajnimi nuk munguan pyetjet dhe komentet e pjesëmarrësve e gjithashtu edhe rekomandimet për të ardhmen me theks në metodën IRAC e cila mundëson që problemi të trajtohet në mënyrë logjike konsistente dhe të plotë. Pra duke vënë në pah çështjen gjyqësore ose problemi që adresohet, pastaj shpjegohet norma ligjore duke vazhduar me aplikimin e saj në faktet specifike të situatës së çështjes për të arritur te konkluzioni me përgjigjen në pyetjen e parashtruar më parë.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive duke shtjelluar edhe raste të ndryshme nga praktika gjyqësore.

Përfitues në këtë trajnim janë Zyrtarë për bashkëpunim profesional nga gjykatat e të gjitha regjioneve si dhe Zyrtar Ligjor nga gjykatat dhe Zyra e kryeprokurorit të Shtetit.
të



Tranjnimi: Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Më 29 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë " Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial ".Në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom direkt/live nga ora 10:00-15:30.

Qëllimi i këtij sesioni trajnues ishte ngritja e njohurive profesionale e stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial për aktet nënligjore si dhe praktikat ligjore të aplikueshme në menaxhimin e rrjedhës së rasteve në gjykata dhe prokurori.

Në kuadër të këtij trajnimi janë trajtuar: regjistrat e gjykatave dhe prokurorive, organizimi i rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës, mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi, menaxhimi efikas i lëndëve bazuar në metodologjinë CEPEJ. Vëmendje e veçantë iu kushtua digjitalizimit të procesit të punës në gjykata dhe prokurori.

Metodologjia e zbatuar gjatë trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Ndihmës administratorët nga gjykatat, referentët, mbikëqyrësit e sektorit të shkrimores dhe zyrtar ligjor nga gjykatat dhe prokuroritë.



Liria e shprehjes dhe liria e mediave ne Kosovë (JUFREX2) - Trajnimi për Trajnerë në Fushën e Lirisë së Shprehjes

Akademia e Drejtësisë së Kosovës me datën 09 tetor 2020 ka organizuar Trajnimin për Trajnerë në bashkëpunim me Projektin "Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave në Kosovë (JUFREX 2)", pjesë e Programit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë".



Ky trajnim u mbajt online dhe iu dedikua profesionistëve ligjorë (gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë) të certifikuar si trajnerë në fushën e lirisë së shprehjes, gjatë fazës së parë të projektit JUFREX.

Trajnimi kishte për qëllim të bashkojë trajnerët tashmë të aftësuar për të shqyrtuar dhe diskutuar Doracakun e ri për lirinë e shprehjes. Doracaku i trajnimit i rifreskuar u theksua se përmban module të reja dhe praktika gjyqësore të reja nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Trajnimi ishte një përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së përdorur gjatë trajnimit të parë për trajnerë dhe ku u prezantua hollësishëm përmbajtja e re e Doracakut në fjalë. Duke marrë parasysh që trajnerët e aftësuar kishin njohuritë dhe përvojën e nevojshme në këtë fushë, trajnimi ishte interaktiv edhe pse ai u mbajt online.

Në këtë trajnim u trajtuan temat në vijim: Rifreskim i njohurive nga trajnimi i parë për trajnerë-JUFREX-1 - Përmbledhja e pikave kryesore të trajnimit dhe objektivat e të nxënit nga trajnimi i parë për trajnerë - JUFREX-1, Fushat kryesore tematike të trajnimit të parë për trajnerë – JUFREX 1, Rast studimi në fushën e shpifjes, Prezantimi i moduleve të reja dhe prezantimi i tyre - Krahasimi i dy versioneve të Doracakut si dhe analizim me pjesëmarrës i këtyre moduleve, Përmbajtja e moduleve dhe diskutim interaktiv si dhe Rasti i studimit nga Doracaku i ri (Siguria dhe mbrojtja e gazetarëve).

Në vazhdim u zbërthyen nocionet si: Liria e shprehjes që është rregulli i përgjithshëm (neni 10 (1)), Kufizimet e lirisë së shprehjes e që janë përjashtim (neni 10 (2)), Testi tre hapësh, dhe Margjina e vlerësimit. Lidhur me Testin tre hapësh të GJEDNJ u potencua se me këtë ajo vlerëson se: A ka pasur ndërhyrje në të drejtën e garantuar me Konventë dhe a është ndërhyrja e parashikuar me ligj?, A e ndjek apo synon ndërhyrja një qëllim legjitim?, A është ndërhyrja e nevojshme në një shoqëri demokratike?

Duke fol për Doktrinën e 'margjinës së vlerësimit' u theksua se ajo u lejon shteteve një shkallë të caktuar të diskrecionit në përcaktimin nëse ekziston apo jo një nevojë shoqërore urgjente për të vendosur kufizim në të drejtën e lirisë së shprehjes. Në lidhje me gjuhën politike kjo margjinë është shumë e ngushtë. Ndërsa në rastet të cilat lidhen me moralin publik kjo margjinë është më e gjerë.

Lidhur me shpifjen u zbërthyen nocionet e Reputacionit, privatësisë (neni 8 dhe 10), Dallimi në mes të fakteve dhe opinioneve, Kritika e ashpër, Efekti frenues dhe Mbrojtja nga shpifja (e vërteta, shprehjet politike, satira, opinionet, interesi publik, shpifja i drejtohet institucionit publik dhe sanksionet joproporcionale).

Në vazhdim u elaborua tematika për Internetin dhe Lirinë e shprehjes - Përgjegjësia për përmbajtjen e gjeneruar nga përdoruesi, E drejta për t'u harruar dhe Jurisprudenca që është zhvilluar aktualisht. Një ashtu vëmendje ju kushtua edhe tematikës mbi Sigurinë e gazetarëve - Rreziqet ndaj gazetarëve, Ndjekja penale e kërcënimeve ndaj gazetarëve, Nxitja e një mjedisi të favorshëm për gazetarinë dhe shmangia e pandëshkueshmërisë, Rekomandimi CM/Rec(2016)4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias.

Ishte me interes zbërthimi i Padive SLAPP - Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (Strategic Laësuits Against Public Participation – SLAPP). Këto padi përdoren nga politikanët dhe biznesmenët e fuqishëm, të cilët nëpërmjet këtyre padive që nuk kanë bazë dhe shans për sukses, kërkojnë nga gazetarët, mediat dhe aktivistët qindra, mijëra e deri në miliona euro dëmshpërblime në emër të "cenimit të reputacionit".

Në pjesën e fundit u trajtua një rast studimor shumë i dobishëm, në trajtimin e të cilit morën pjesë të gjithë pjesëmarrësit. Ky rast dhe debati pas tij u përmbyll me sqarimet dhe konkludimet e trajnuesit të këtij trajnimi.



Vijueshmëria në trajnime në PTV e prezantuar përmes grafikoneve






Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Instutucioneve Tetor 2020
28
160
14
4
1
18
6
15
5
1
17
2
3
2
20
7
44
3
1
53
1
5
6
6
4
4
2
10
1
3
4
25
4
5
5
2
Gjykata e Apelit
GJTH Prishtinë
GJTH Prishtinë - Dega Podujevë
GJTH Prishtinë - Dega Graçanicë
GJTH Prishtinë - Dega Lipjan
GJTH Ferizaj
GJTH Ferizaj - Dega Kaçanik
GJTH Gjilan
GJTH Gjilan - Dega Viti
GJTH Gjilan - Dega Kamenicë
GJTH Pejë
GJTH Pejë - Dega Klinë
GJTH Pejë - Dega Istog
GJTH Pejë - Dega Deçan
GJTH Gjakovë
GJTH Gjakovë - Dega Malishevë
GJTH Prizren
GJTH Prizren - Dega Suharekë
GJTH Prizren - dega Dragash
GJTH Mitrovicë
GJTH Mitrovicë - Dega në Skenderaj
GJTH Mitrovicë - Dega në Zubin Potok
GJTH Mitrovicë - Dega në Leposaviq
GJTH Mitrovicë - Dega në Vushtrri
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
Prokuroria Speciale e Kosovës
Prokuroria e Apelit
PTH Ferizaj
PTH Gjakovë
PTH Gjilan
PTH Pejë
PTH Prishtinë
PTH Prizren
PTH Mitrovicë
Ministria e Drejtësisë
Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave


Pjesëmarrja sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike Tetor 2020
282
209
429
57
5
Meshkuj
Femra
Shqiptarë
Serb
Pakica tjera


Punëtori - Tetor 2020
1
42
5
6
31
23
19
42
Punëtori të realizuara
Gjithësejë pjesëmarrës
Gjyqtarë
Prokurorë
Të tjerë
Meshkuj
Femra
Shqiptarë


Nr. i trajimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive Tetor 2020
2
26
12
14
25
1
Trajnime të realizuara
Gjithësej pjesëmarrës
Meshkuj
Femra
Shqiptarë
Serb


Nr. i trajnimeve dhe i pjesëmarrjes në TiT Tetor 2020
1
6
3
2
1
4
2
6
Trajnime të realizuara
Gjithësejë pjesëmarrës
Gjyqtarë
Prokurorë
Të tjerë
Meshkuj
Femra
Shqiptarë

Kurset e mësimit në distancë-Elearning

Gjatë muajit tetor platforma e mësimit në distancë ka vazhduar të jetë e hapur për pjesëmarrësit e interesuar (Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive si dhe për studentët e Fakulteteve Juridike) pa afat të caktuar kohor.

Në kuadrin e kësaj platforme janë 18 kurse të çasshme online, 8 prej të cilave edhe në gjuhën serbe.

Më 20 korrik 2020, sipas Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Nr. 06/2019) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Nr. 06/2017) është lëshuar online edhe kursi obligativ "Etika profesionale" për gjyqtarët e Republikës së Kosovës.

Për në detaje janë tabelat të cilat prezantojnë vijueshmërinë dhe progresin në ndjekjen e kurseve sipas temës në këtë platformë.

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Shqip)	212	75%	40	14%	29	10%
Etika Profesionale I	219	78%	46	16%	16	6%
Etika Profesionale II	232	83%	21	7%	28	10%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Serbisht)	27	10%	17	6%	237	84%
Etika Profesionale I (Serbisht)	25	9%	81	29%	175	62%
Etika Profesionale II (Serbisht)	24	9%	50	18%	207	74%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Masat e Diversitetit	3	3%	11	10%	99	88%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Menaxhimi Efektiv	3	18%	12	71%	2	12%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Drejtësia për fëmijë aspekti Civil	16	16%	19	17%	76	67%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Drejtësia për fëmijë aspekti Penal	10	9%	16	14%	87	77%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Hetimi dhe zbulimi i Kor-rupsionit	11	10%	10	9%	92	81%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Korrupsioni sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar	7	6%	7	6%	99	88%
Emri i Kursit	**Kompletimi i Kursit**	**Përqindja**	**Në Pro-gres**	**Përqindja**	**Nuk kanë filluar fare**	**Përqindja**
Menaxhimi i Gjykatës	13	12%	6	5%	94	83%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Udhëheqësia - Lidershipi	11	10%	9	8%	93	82%
Emri i Kur-sit	**Kompletimi i Kursit**	**Përqindja**	**Në Pro-gres**	**Përqindja**	**Nuk kanë filluar fare**	**Përqindja**
E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Shqip)	9	8%	19	17%	85	75%
E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Serbisht)	3	23%	5	38%	5	38%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Faza e ak-takuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Shqip)	20	18%	15	13%	78	69%
Faza e ak-takuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Serbisht)	2	15%	4	31%	7	54%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Menaxhimi i stresit (Shqip)	38	34%	20	18%	55	49%
Menaxhimi i stresit (Serbisht)	6	46%	3	23%	4	31%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Shkathtësitë e komunikimit social (Shqip)	9	8%	8	7%	96	85%
Shkathtësitë e komunikimit social (Serbisht)	2	15%	4	31%	7	54%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Trajnimi për imple-mentimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Shqip)	7	6%	6	5%	100	88%
Trajnimi për imple-mentimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Serbisht)	2	15%	3	23%	8	62%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Shqip)	15	13%	40	35%	58	51%
Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Serbisht)	1	15%	4	31%	7	54%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Anglishtja Ligjore	39	35%	23	20%	51	45%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Teknologjia In-formative	32	28%	14	12%	67	59%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Pro-gres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
Dhuna në Familje (Shqip)	0	0%	20	87%	3	13%
Dhuna në Familje (Serbisht)	0	0%	3	13%	20	87%

Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
https://ad.rks-gov.net